

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
01	22.10.2025	1. A ka aktualisht nëpunës të emëruar në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve", pranë Agjencisë Kombëtare të Pyjeve? 2. Nëse përgjigja është "PO", kur është emëruar (data/muaji/viti) dhe cila është baza ligjore ku mbështetet emërimi, qoftë edhe i përkohshëm i nëpunësit? 3. Nëse përgjigja është "JO", kush i kryen funksionet e këtij pozicioni pune dhe përse nuk është rishpallur procedura e plotësimit të këtij pozicioni pune vakant?	23.10.2025	1. Pranë Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, nuk ka asnjë nëpunës të emëruar në mënyrë të përhershme apo të përkohshme, në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. 2. Detyrat funksionale të këtij pozicioni i kryejnë specialistët së bashku me Drejtorinë e Drejtorisë, kjo në zbatim të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar. Për sa më sipër, pozicioni i Përgjegjësit të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, si edhe vakancat e tjera pranë këtij institucioni, do të ri-shpallen ditët në vijim.	E plotë	0

02	14.10.2025	1. Sa punonjës kanë kërkuar lejen vjetore në periudhën 1 Janar 2025 deri në 15 Maj 2025? 2. Sa prej këtyre lejeve të kërkuara janë aprovuar për 1 Janar 2025 deri në 15 Maj 2025? 3. A ka pasur raste kur punonjësit kanë kërkuar leje vjetore pa të drejtë page gjatë periudhës 1 Janar 2025 deri në 15 Maj 2025? Nëse po, sa leje janë aprovuar? 4. Sa punonjës kanë paraqitur raport mjekësor gjatë periudhës 1 Janar 2025 deri në 15 Maj 2025?	24.10.2025	Përgjigje në lidhje me lejet vjetore ; • Për vitin 2023 kanë kërkuar 6 nëpunës leje vjetore përkatësisht: · 1 në muajin shkurt, të miratuar · 2 në muajin mars, të miratuar · 1 në muajin prill, të miratuar · 2 në muajin maj, të miratuar • Për vitin 2024 kanë kërkuar 12 nëpunës leje vjetore përkatësisht: · 3 në muajin janar, të miratuar · 3 në muajin shkurt, të miratuar · 3 në muajin mars, të miratuar · 2 në muajin prill të miratuar · 1 në muajin maj, të miratuar • Për vitin 2025 kanë kërkuar 16 nëpunës leje vjetore përkatësisht · 3 në muajin shkurt, të miratuar · 8 në muajin mars, të miratuar · 3 në muajin prill, të miratuar · 2 në muajin maj, të miratuar Për sa i përket pikës 3, të kërkesës ju bëj me dije se nuk ka patur raste të punonjësve që të kenë kërkuar leje pa të drejtë page. Përgjigje në lidhje me raportet mjekësore ; • Për vitin 2023 kanë kërkuar 13 nëpunës leje vjetore përkatësisht: · 2 në muajin Janar · 4 në muajin Shkurt · 2 në muajin Mars	E plotë	0
----	------------	--	------------	--	---------	---

				· 2 në muajin Prill · 6 në muajin Maj • Për vitin 2024 kanë kërkuar 9 nëpunes leje vjetore përkatësisht: · 2 në muajin Janar · 4 në muajin Shkurt · 2 në muajin Mars · 3 në muajin Prill · 3 në muajin Maj • Për vitin 2025 kanë kërkuar 12 nëpunes leje vjetore përkatësisht: · 4 në muajin Janar · 2 në muajin Shkurt · 1 në muajin Mars · 6 në muajin Prill · 5 në muajin Maj		
03	04.09.2025	1. Sa është sipërfaqja e pyjeve të djegura nga zjarret përgjatë vitit 2025, në territorin e Republikës së Shqipërisë? 2. Cilat janë qarqet ose zonat e prekura nga zjarret në Shqipëri për vitin 2025? 3. A mund të na vini në dispozicion statistika ose harta të zjarreve për 5 vitet e fundit në Shqipëri? 4. Çfarë masash merr Agjencia për të parandaluar dhe minimizuar zjarret pyjore? 5. Sa fonde janë të dedikuara për masat parandaluese dhe për	24.10.2025	Përgjigja 1 : Sipërfaqja e pyjeve të djegura gjatë vitit 2025: Deri në datën 20.10.2025, sipas të dhënave paraprake të mbledhura nga strukturat vendore dhe të grumbulluara e të përpunuara në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve, sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave të djegura në territorin e Republikës së Shqipërisë është 8,760 ha hektarë, pasojë e 185 zjarreve të rëna dhe të raportuara. Sipërfaqja e përshkuar (jo e djegur plotësisht) është 24,301 ha. Të dhënat përfundimtare do të përditësohen në vazhdim në raportin vjetor të Agjencisë. Përgjigja 2 :	E plotë	0

		t'iu përgjigjur emergjencave të zjarrit?	Qarqet/Zonat e prekura nga zjarret: Zjarret janë raportuar kryesisht në qarqet Dibër, Elbasan, Vlorë, Gjirokastrë, Lezhë, Kukës, Shkodër, me intensitet më të lartë në bashkinë Lezhë, Gramsh, Has, Gjirokastrë, Klos, Dibër, Vau i Dejës, Selenicë dhe Vlorë. Nga raportimet e deri më tanishme sipërfaqja e përgjithshme e përshkruar në pyje dhe kullota arrin në 24,301 ha. Përgjigja 3 : Statistika/harta për 5 vitet e fundit: Ne nuk disponojmë harta të 5 viteve të fundit, vetëm nëse i referoheni EFFIS https://effis.jrc.ec.europa.eu Të dhënat nga EFFIS janë të saktësisë mbi 30 ha dhe shpesh nuk ndajnë qartë formën e përdorimit. Përgjigja 4 : Masat parandaluese dhe reagimi ndaj emergjencave: Agjencia Kombëtare e Pyjeve nuk është institucioni direkt përgjegjës për zjarret por ka si mision zbatimin e ligjit të pyjeve dhe akteve të tjera ligjore për pyjet nga administratorët e pyjeve, bashkitë dhe zonat e mbrojtura si dhe monitoron masat parandaluese të administratës së bashkive mbi organizimin e sistemit të vrojtimit-sinjalizimit duke zbatuar të gjitha detyrimet sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile dhe për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin. Në fillim të çdo viti bashkive ju kërkohet të hartojnë planin për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve, për		
--	--	---	--	--	--

			sipërfaqen e fondit pyjor kombëtar në territorin e tyre, ku përfshihen mjetet në dispozicion, si dhe numri i personave të organizuar në njësitë e posaçme për këtë qëllim, duke koordinuar dhe zbatuar të gjitha përcaktimet e ligjit përkatës për mbrojtjen civile, vlerësimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe planin vendor për emergjencat civile. Planin e masave parandaluese duhet ta miratojnë në këshillin bashkiak brenda muajit mars të cdo viti. Përgjigja 5 : Fonde të dedikuara: Agjencia Kombëtare e Pyjeve nuk disponon fonde të dedikuara për masat parandaluese të zjarreve.		
--	--	--	--	--	--